

MONITORIMI I PLURALIZMIT TË MEDIAS NË EPOKËN DIGITALE

APLIKIMI I MONITORIMIT TË PLURALIZMIT TË MEDIAS NË BASHKIMIN EVROPIAN, SHQIPËRI, REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, MALIN E ZI, SERBI DHE TURQI.

Raport Kombëtar: Shqipëri

Kristina Voko, Rrjeti Ballkanik për Gazetari Investigative në Shqipëri
Besar Likmeta, Rrjeti Ballkanik për Gazetari Investigative në Shqipëri

Raporti i Projektit Studimor

Edicioni -
Korrik 2022




TABELA E LËNDËS

1. Rreth projektit	4
1.1. Përmbledhje e projektit	4
1.2. Metodologjia	4
2. Hyrje	6
3. Rezultatet nga mbledhja e të dhënave: vlerësimi i rreziqeve ndaj pluralizmit të medias	8
3.1. Mbrojtja Themelore (58% - Rrezik i mesëm)	10
3.2. Pluralizmi i Tregut (87% - Rrezik i lartë)	12
3.3. Pavarësia Politike (69% - Rrezik i lartë)	14
3.4. Gjithëpërfshirja Sociale (64% - Rrezik i mesëm)	16
4. Pluralizmi në mjedisin online: vlerësimi i rreziqeve	19
5. Konkluzione	22
6. Shënime	24
7. Referenca	26
Anekse I. Ekipi i studimit kombëtar	
Anekse II. Grupi i Ekspertëve	

© European University Institute 2022

Përmbajtja dhe kapitujt specifikë © Kristina Voko, Besar Likmeta, 2022

Ky raport është publikuar nga European University Institute,
Robert Schuman Centre for Advanced Studies.

Ky tekst mund të shkarkohet vetëm për përdorim personal kërkimor. Për riprodhimin e tij për qëllime të tjera, qoftë në print ose në version elektronik, nevojitet miratimi paraprak i autorëve. Në raste të citimit ose kuotimit, duhet të referohen emrat emrat e plotë të autorëve, redaktorëve, tituli, viti dhe botuesi.

Kërkesat duhet të drejtohen në adresën cmpf@eui.eu

Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim reflektojnë opinionin individual të autorëve dhe jo ato të European University Institute.

The English version of this report prevails over this translation.

Centre for Media Pluralism and Media Freedom
Robert Schuman Centre for Advanced Studies

Raporti i Projektit Studimor -
RSC / Centre for Media Pluralism and Media Freedom
Publikuar në Korrik 2022

European University Institute
Badia Fiesolana
I – 50014 San Domenico di Fiesole (FI)



Me mbështetjen e Programit Erasmus+ të Bashkimit Evropian. Komisioni Evropian mbështet EUI përmes buxhetit të BE-së. Ky publikim reflekton pikëpamjet e vetë autorëve dhe Komisioni Evropian nuk mund të mbahet përgjegjës për çdo përdorim të mundshëm të informacionit që përfshihet në të.

1. Rreth projektit

1.1. Përmbledhje e projektit

Monitorimi i Pluralizmit të Medias (MPM) është një punë kërkimore që ka për qëllim identifikimin e rreziqeve potenciale ndaj pluralizmit të medias në vendet anëtare dhe vendet candidate për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Ky raport narrativ është realizuar brenda kuadrit të zbatimit të MPM-së në vitin 2021. Projekti është zbatuar në 27 vende anëtare të BE-së, si dhe në Shqipëri, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, Serbi dhe Turqi. Ky projekt, në kuadër të një aksioni përgatitor të Parlamentit Evropian, u mbështet nga një grant i dhënë nga Bashkimi Evropian për Qendrën për Pluralizmin e Medias dhe Lirinë e Medias (CMPF) pranë European University Institute.

1.2. Metodologjia

Partnerët e CMPF-së, të cilët janë kërkues të pavarur dhe me eksperiencë në vendet përkatëse, kryejnë mbledhjen e të dhënave dhe janë autorë të raporteve narrative, me përjashtim të rastit të Italisë ku mbledhja e të dhënave u krye në mënyrë të drejtpërdrejtë nga skuadra e CMPF-së. Kërkimi është bazuar një pyetësor dhe udhërrëfyes të standardizuar të zhvilluara nga CMPF-ja.

Në Shqipëri, CMPF-ja hyri në partneritet me Kristina Voko dhe Besar Likmeta (Rrjeti Ballkanik për Gazetari Investigative në Shqipëri), të cilët kryen mbledhjen e të dhënave, llogaritën dhe komentuan mbi variablat në pyetësor dhe intervistuan ekspertët. Raporti është riparë nga stafi i CMPF-së. Për më shumë, për të siguruar se gjetjet janë të sakta dhe të besueshme, një grup ekspertësh kombëtarë në secilin vend rishikuan përgjigjet, në veçanti për pyetjet vlerësuese (shiko Aneksin II për listën e ekspertëve). Për një listë vendesh të përzgjedhura, raporti final i vendit u vlerësua nga një ekspert i pavarur vendor (shiko Aneksin III).

Rreziqet ndaj pluralizmit të medias vlerësohen në katër fusha kryesore tematike, të cilat konsiderohet se pasqyrojnë fushat kryesore të rrezikut për pluralizmin dhe lirinë e medias: Mbrojtja Bazë, Pluralizmi i Tregut, Pavarësia Politike dhe Gjithëpërfshirja Sociale. Rezultatet mbështeten në vlerësimin e një numri indikatorësh për secilën fushë tematike (shiko Tabelën 1 më poshtë).

Mbrojtja Bazë	Pluralizmi i Tregut	Pavarësia Politike	Gjithëpërfshirja Sociale
Mbrojtja e lirisë së shprehjes	Mbrojtja e lirisë së shprehjes	Pavarësia politike e medias	Aksesi i minoriteteve në media
Mbrojtja e lirisë së informimit	Përqendrimi i medias informative	Autonomia editoriale	Aksesi i bashkësive vendore/rajonale në media dhe mediat komunitare
Profesioni i gazetarit, standardet dhe mbrojtja	Përqendrimi i platformave online dhe zbatimi i rregullave për konkurrencën	Media audiovizive, platformat online dhe zgjedhjet	Aksesi i grave në media
Pavarësia dhe efikasiteti i autoritetit të medias	Qëndrueshmëria e medias	Rregulimi shtetëror mbi burimet dhe mbështetja për sektorin e medias	Alfabetizmi mediatic
Shpërndarja universale e medias konvencionale dhe aksesi në internet	Ndikimi tregtar dhe i pronarëve mbi përmbajtjen editoriale	Pavarësia dhe financimi i mediave publike	Mbrojtja ndaj gjuhës së paligjshme dhe të dëmshme

Tabela 1: Fushat dhe treguesit e Monitorimit të Pluralizmit të Medias

Dimensioni dixhital

Monitori nuk e konsideron dimensionin dixhital si një fushë të izoluar, por si të ndërthurur me median tradicionale dhe parimet ekzistuese të pluralizmit të medias dhe lirisë së shprehjes. Pavarësisht kësaj, Monitori lejon llogaritjen më vete të rrezikut specifik për fushën dixhitale, ndërsa raporti përmban një analizë specifike të rreziqeve në mjedisin e lajmeve online.

Përlllogaritja e rrezikut

Rezultatet për çdo fushë tematike dhe tregues prezantohen në një shkallë nga 0 në 100%.

Vlerësimi nga 0 deri në 33%: rrezik i ulët,

Vlerësimi nga 34 deri në 66%: rrezik i mesëm

Vlerësimi nga 67 deri në 100%: rrezik i lartë.

Në nivelin e treguesve, pikët 0 vlerësohen 3% dhe pikët 100 vlerësohen 97% si rregull, për të shmangur një vlerësim sipas të cilit nuk ka fare rrezik ose siguri.

Heqje e përgjegjësi: *Përmbajtja e raportit jo domosdoshmërisht përfaqëson këndvështrimin e CMPF-së dhe as nuk reflekton domosdoshmërisht qëndrimin e anëtarëve që përbëjnë Grupin e Ekspertëve. Ai prezanton vetëm mendimet e skuadrës kombëtare të vendit përkatës që kryen mbledhjen e të dhënave dhe janë autorë të raportit. Për shkak të përditësimeve dhe shtjellimeve të pyetësorit, pikët e dhëna në MPM2022 mund të mos jenë tërësisht të krahasueshme me edicionet e mëparshme të MPM-së. Për më shumë detaje, shikoni raportin e CMPF-së më MPM2022, i cili do të jetë i disponueshëm së shpejti në: <http://cmpf.eui.eu/media-pluralism-monitor/>.*

2. Hyrje


- **Popullsia:** Republika e Shqipërisë është një vend me 2.8 milionë banorë, dhe shtrihet në një zonë prej 28,748 kilometrash katrore. Shqipëria gjendet në Ballkanin Perëndimor përgjatë brigjeve të deteve Adriatik dhe Jon. Ajo kufizohet nga Mali i Zi dhe Kosova në veri, Maqedonia e Veriut në lindje dhe Greqia në jug.
- **Minoritetet:** Shumica e popullsisë është shqiptare dhe sipas censusit të vitit 2011, vetëm 1.5% e popullsisë së vendit i përket minoriteteve etnike (INSTAT, 2012). Të dhënat e censusit të vitit 2011 mbeten të debatueshme për shkak se vetëm 83.2% e të intervistuarve deklaruan veten shqiptarë etnikë ndërsa 14.07% refuzuan t'i përgjigjen pyetjeve në lidhje me kombësinë. Një census i ri i planifikuar për vitin 2020 u shty për vitin 2022. Në vitin 2020, censusi nuk mund të zhvillohej për shkak të pandemisë COVID-19 ndërsa më 2021 për shkak se ishte vit zgjedhor. Sipas Nenit 3 të ligjit nr. 96/2017 "Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë"^[1], minoritetet e njohura etnike dhe/ose kulturore në Shqipëri janë: grekët, maqedonasit, arumunët, romët, egjiptianët, malazezët, boshnjakët, serbët dhe bullgarët. Minoriteti grek përbën minoritetin më të madh etnik në Shqipëri dhe ai është i përqendruar kryesisht në jug të vendit, përgjatë kufirit me Greqinë. Minoriteti etnik maqedonas dhe minoriteti kulturor rom janë dy grupimet më të mëdha pasuese.
- **Situata ekonomike:** Në vitin 2021 ekonomia e Shqipërisë regjistroi një përmirësim nga recesioni ekonomik i shkaktuar nga pandemia e COVID-19 një vit më parë. Për tre tremujore radhazi, nga tremujori i fundit i vitit 2020 deri në tremujorin e dytë të vitit 2021, ekonomia regjistroi një rritje pozitive të prodhimit të brendshëm bruto (PBB). Rritja e PBB-së arriti gati 18 për qind në tremujorin e dytë, e ushqyer nga një përmirësim i tregtisë vendase, konsumi i familjeve i nxitur nga remitancat, si dhe industria e ndërtimit. Të ardhurat nga eksporti në tetë muajt e parë të 2021 tejkaluan nivelet para pandemisë në 2019 me afro 15 për qind në vlerë nominale. Turizmi gjithashtu u rimëkëmb në tremujorin e dytë dhe të tretë, me numrin e turistëve në periudhën qershor-gusht të ngjashëm me periudhën para pandemisë (BERZH, 2021).
- **Situata politike:** Në vitin 2021, mjedisi politik në Shqipëri ishte relativisht i qetë. Zgjedhjet e përgjithshme u mbajtën më 25 prill 2021, pas një marrëveshjeje politike ndërpartiake që çoi në reformën zgjedhore, kryesisht në përputhje me rekomandimet e OSBE-ODIHR. Në zgjedhjet parlamentare, Partia Socialiste në pushtet e kryeministrit Edi Rama fitoi një mandat të tretë të paprecedentë në detyrë. Megjithatë, si në zgjedhjet e mëparshme elektorale, fushata u shoqërua me akuza për blerje votash dhe përdorimin e burimeve publike për përfitime elektorale nga partia në pushtet. Mbulimi mediatik gjatë fushatës ishte i anuar drejt Partisë Socialiste në pushtet (Likmeta, B., 2021a). Pas zgjedhjeve, opozita protestoi, por nuk hodhi poshtë legjitimitetin e zgjedhjeve, të cilat i cilësoi si "një masakër elektorale". Në maj të vitit 2021, ish-kryeministri Sali Berisha dhe familja e tij u shpallën "non grata" nga Departamenti Amerikan i Shtetit për përfshirjen e tij në korrupsion. Berisha u përjashtua nga grupi parlamentar i Partisë Demokratike, gjë e cila çoi në një konflikt me kryetarin e partisë Lulzim Basha. Vendimi për përjashtimin e ish-kryeministrit nga grupi parlamentar krijoi një përçarje mes mbështetësve të Partisë Demokratike, duke çuar në një luftë për pushtet mes Berishës dhe Bashës. (Komisioni Evropian, 2021).
- **Tregu mediatik:** Pavarësisht numrit të lartë të mediave të shkruara, online dhe televizive, tregut mediatik të Shqipërisë i mungon pluraliteti, me të ardhura dhe audiencë të përqendruar në duart e pak pronarëve, të cilët përdorin mediat e tyre për të çuar përpara axhenda politike dhe ekonomike. Interesat

politike dhe ekonomike të pronarëve janë faktorë të fortë shtytës për censurën dhe autocensurën e gazetarëve, ndërkohë që burimi i financimit të mediave mbetet i errët. Situata ekonomike e mediave lokale u përkeqësua nga pandemia COVID-19, e cila përgjithësisht çoi në një rënie të të ardhurave nga reklamat (Komisioni Evropian, 2021).

- **Mjedisi rregullator:** Kushtetuta e Shqipërisë garanton lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias. Media audiovizive rregullohet nga ligji nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”^[2], ndërsa ligji nr. 7756 i vitit 1993 “Mbi Shtypin”^[3] i ndryshuar ka vetëm një nen, i cili thotë se “Media është e lirë dhe se liria e medias mbrohet nga ligji”. Pas një opinioni negativ nga Komisioni i Venecias (2020) dhe kritikave nga organizata mediatike vendase dhe ndërkombëtare, qeveria bëri me dije se kishte rishqyrtuar miratimin e një sërë projekt-amendamentesh të ligjit nr. 97/2013, “Për Mediat Audiovizive”, për të zgjeruar fushëveprimin dhe kontrollin e përmbajtjes në organet e mediave online (Komisioni Evropian, 2021). Në korrik 2021, parlamenti emëroi zëdhënësen e qeverisë së qendrës së majtë si kryetare të bordit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, duke ngritur shqetësimin për paanshmëri të institucionit (Erebara, Gj., 2021). Në shtator 2021, qeveria njoftoi krijimin e një agjencie të re për të koordinuar përpjekjet e komunikimit publik. Megjithatë, organizatat vendase dhe ndërkombëtare të të drejtave paralajmëruan se agjencia e re do të përdoret për të forcuar më tej kontrollin mbi fluksin e informacionit publik (Media Freedom Rapid Response, 2021)
- **COVID-19:** Në vitin 2021, Shqipëria regjistroi 152,360 raste të reja me koronavirus. Nga fillimi i pandemisë deri më 21 dhjetor 2021, u regjistruan 3,217 viktima nga COVID-19. Masat kufizuese mbetën në fuqi në vitin 2021 si pjesë e përpjekjeve të autoriteteve për të frenuar përhapjen e koronavirusit të ri (AKSHI, 2021).

3. Rezultatet nga mbledhja e të dhënave: vlerësimi i rreziqeve ndaj pluralizmit të medias

Shqipëri: Fushat e Rrezikut të Pluralizmit të Medias



JS chart by amCharts



Gjatë vitit 2021, rreziku i pluralizmit të medias në Shqipëri varioi nga niveli mesatar në atë të lartë në katër fushat kryesore të vlerësuara nga treguesit e Monitorimit të Pluralizmit të Medias. Skena mediatike në vendin e vogël ballkanik prej 2.8 milionë banorësh renditet me rrezik të lartë për sa i përket Pluralizmit të Tregut (87%) dhe Pavarësisë Politike (69%), ndërsa shënoi rrezik mesatar në fushat e Gjithëpërfshirjes Sociale (64%) dhe Mbrojtjes Themelore (58%).

Megjithëse kuadri ligjor i Shqipërisë parashikon masa mbrojtëse për lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias, në praktikë, këto liri kufizohen nga interesat politike dhe ekonomike të pronarëve të medias, përqendrimi i tregut dhe audiencës në duart e pak njerëzve të fuqishëm, konglomeratet mediatike në pronësi familjare, paditë strategjike kundër pjesëmarrjes publike (SLAPPs) ndaj gazetarëve kritikë, zbatimi i dobët i legjislacionit për të drejtat në punë, vetëcensura e përhapur dhe ndërhyrjet e panevojshme politike në pavarësinë e enteve rregullatore të medias.

Emërimi i ish-zëdhënëses së qeverisë si kreu i Autoritetit të Mediave Audiovizive në vitin 2021 ka cënuar dhe më tej paanshmërinë e rregullatorit të medias (Erebara, Gj., 2021). Ndërkohë, krijimi i Agjencisë për Media dhe Informim, një institucion i ri që do të mbikëqyrë të gjitha komunikimet e qeverisë, do të monitorojë mediat sociale dhe do të kryejë sondazhe, është krahasuar nga organizatat vendase dhe ndërkombëtare të të drejtave me një ministri bona fide propagande (Media Freedom Rapid Response, 2021), duke ngritur shqetësime për përqendrim të mëtejshëm në ofrimin e informacionit, të dëmtuar sakaq nga kufizimet e vendosura vitin e kaluar për shkak të pandemisë së COVID-19. Sipas raporteve të

publikuara nga Platforma e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Gazetarëve, shtatë sulme ndaj sigurisë fizike, ngacmime dhe akte të tjera që kanë efekte rrëqethëse në lirinë e medias u regjistruan në vitin 2021 në vend.

Fusha me rezultatin më negativ për lirinë e medias në Shqipëri gjatë vitit 2021 është grupi i treguesve të **Pluralizimit të Tregut**. Edhe pse kjo fushë u përmirësua me disa pikë përqindjeje në krahasim me vitin 2020, ajo ende konsiderohet me shkallë të lartë rreziku (87%), për shkak të mungesës së transparencës në pronësinë e medias, mungesës së të dhënave mbi përqendrimin në arenën e platformave online, shoqëruar me mungesën e zbatimit të konkurrencës, mungesës së qëndrueshmërisë së medias dhe ndikimit të panevojshëm të interesave politike dhe ekonomike të pronarëve të mediave në përmbajtjen editoriale.

Pas Pluralizimit të Tregut, fusha e dytë e renditur më keq në MPM për Shqipërinë në vitin 2021 është grupi i treguesve të lidhur me **Pavarësinë Politike** (69%), i cili u përkeqësua nga një vlerësim mesatar i rrezikut në 2020 (64%). Kjo fushë ndikohet veçanërisht nga mungesa e pavarësisë editoriale dhe pavarësisë politike të medias lokale që renditen me rrezik të lartë, dhe më pak nga mungesa e pavarësisë së radio-televizionit publik dhe rregullatorit të medias ose parashikimet që rregullojnë mediat dhe platformat audiovizive gjatë zgjedhjeve, të cilat renditen me rrezik mesatar.


Shqipëria vlerësohet me rrezik mesatar për fushën e **Gjithëpërfshirjes Sociale** (64%). Një rezultat i tillë është për shkak të nivelit të dobët të aksesit në media për gratë, mungesës së politikave koherente të edukimit mediatic, si dhe mungesës së masave efikase mbrojtëse kundër gjuhës së paligjshme dhe të dëmshme, si në median tradicionale ashtu edhe në hapësirën dixhitale. Nga ana tjetër, treguesi i 'Aksesit në media për komunitetet lokale dhe rajonale dhe mediat komunitare' është i vetmi tregues për të cilin Shqipëria ka regjistruar një rezultat të ulët rreziku (31%).

Treguesit për **Mbrojtjen Themelore** u vlerësuan si rrezik mesatar në vitin 2021 (58%), vetëm një pikë përqindje më i ulët se në vitin 2020 (59%). Treguesi i renditur më negativisht në fushën e Mbrojtjes Themelore lidhej me shtrirjen e mediave tradicionale dhe aksesin në internet (75%). Probleme u regjistruan edhe për treguesit e profesionit të gazetarit, standardeve dhe mbrojtjes së tyre, mbrojtjes së lirisë së shprehjes dhe pavarësisë të autoritetit të medias, të cilët renditen të gjithë si rrezik i mesëm.

Në vitin 2021, pandemia e COVID-19 vazhdoi të ndikonte negativisht në aspekte të ndryshme të pluralizmit mediatic, veçanërisht në lidhje me aksesin e gazetarëve në institucionet publike dhe rritjen e fluksit të dezinformimit, fushatave të lajmeve të rreme dhe teorive konspirative në lidhje me pandeminë dhe vaksinat, për përfitime ideologjike dhe ekonomike.

3.1. Mbrojtja Themelore (58% - Rrezik i mesëm)

Treguesit e Mbrojtjes Themelore përfaqësojnë shtyllën kurrizore rregullatore në sektorin e medias në çdo demokraci bashkëkohore. Ata masin një numër fushash potenciale me rrezik, përfshirë ekzistencën dhe efikasitetin e zbatimit të masave mbrojtëse rregullatore për lirinë e shprehjes dhe të drejtën për informim; statusin e gazetarëve në çdo vend, përfshirë mbrojtjen dhe aftësinë për të punuar; pavarësinë dhe efikasitetin e organeve rregullatore kombëtare që kanë kompetencë për të rregulluar sektorin e medias dhe përhapjen e medias tradicionale e aksesin në internet.



Gjatë vitit 2021, fusha e Mbrojtjes Themelore është vlerësuar me rrezik mesatar (58%), duke regjistruar pothuajse të njëjtin vlerësim si një vit më parë. Treguesi i renditur më negativisht në këtë fushë për vitin 2021 është **Përhapja universale e medias tradicionale dhe aksesin në internet (75%)**, i cili vlerësohet me rrezik të lartë. Ky tregues specifik vlerësohet me rrezik të lartë për shkak të depërtimit të ulët të rrjetit me brez të gjerë në vend dhe mungesës së parashikimeve në ligjin nr. 9918 i vitit 2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”^[4] mbi zbatimin e parimit të neutralitetit të rrjetit.

Edhe pse Neni 22 i Kushtetutës së Shqipërisë^[5] dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut njohin të drejtat themelore mbi **Mbrojtjen e lirisë së shprehjes (57%)** dhe kufizimet janë të përcaktuara qartë në kuadrin rregullator, këto të drejta nuk respektohen gjithmonë. Në vitin 2021, Shqipëria renditej e 83-ta nga 180 vende në Indeksin Botëror të Lirisë së Shtypit (RSF, 2021), duke fituar një pozicion në renditje krahasuar me një vit më parë. Sipas RSF-së, qeveria rriti presionin ndaj medias vitin e kaluar duke kërcënuar sërish se do të miratonte një ligj të ri për shpifjen, pavarësisht kritikave nga organizatat e lirisë së medias dhe këshillave të Komisionit të Venecias kundër tij. Pasi u bllokua nga presidenti në vitin 2020, ky ligj do të sillte për pasojë një rritje të censurës në një vend ku qeveria tashmë kufizon aksesin e gazetarëve në informacionin e mbajtur nga shteti dhe përdor ndarjen e licencave për të kontrolluar peizazhin mediatik. Fati i projektligjit për shpifjen mbeti i paqartë edhe gjatë vitit 2021, pasi ai vazhdon të shfaqet ende në kalendarin e Komisionit Parlamentar për Median.


Treguesi për **Mbrojtjen e së drejtës për informim** është vlerësuar me rrezik të mesëm (52%) gjatë vitit 2021. E drejta për informim njihet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe rregullohet me Ligjin nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”^[6]. Megjithëse shumica e kufizimeve për të drejtën e informimit janë të përcaktuara në ligj, nuk ka dispozita të qarta për të gjitha llojet e kufizimeve, veçanërisht ato që lidhen me aksesin në informacionin e prodhuar nga institucionet gjyqësore. Refuzimet e aksesit në informacion mund të apelojnë tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe më pas, në Gjykatën Administrative, por këto mekanizma kërkojnë kohë dhe nuk janë gjithmonë efektive. Gjithashtu, vendimet e Komisionerit për të Drejtën për Informim nuk janë të detyrueshme për zyrtarët e administratës publike (Komisioni Evropian, 2021). Krijimi i Agjencisë për Media dhe Informim në shtator 2021 si një organ i ri për të kontrolluar të gjitha komunikimet e qeverisë ngriti alarmin tek organizatat vendase dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut për kufizimin e fluksit të informacionit nga ana e qeverisë (Media Freedom Rapid Response, 2021).

Treguesi i dytë i vlerësuar më negativisht në këtë fushë është ai lidhur me **Profesionin e gazetarit, standardet dhe mbrojtjen e gazetarit** (66%). Ky tregues rezulton i dobët në vitin 2021 për shkak të kushteve të pafavorshme të punës me të cilat përballen gazetarët shqiptarë. Sipas Barometrit Kombëtar të Lirisë së Medias në Shqipëri (Komiteti Shqiptar i Helsinkit, 2021), 30.2% e gazetarëve raportojnë se nuk kanë një kontratë pune të rregullt me punëdhënësit e tyre. Gjithashtu, Indeksi i fundit i Sigurisë së Gazetarëve të Ballkanit Perëndimor (Safejournalists.net, 2021) thotë se të drejtat e punës nuk respektohen plotësisht, veçanërisht në mediat private, mediat lokale dhe mediat online. Sipas Indeksit, gazetarët e rinj dhe gazetarët gra përballen me akoma më shumë sfida. Mungesa e kontratave të punës, politikat joadekuate të mbështetjes dhe sigurisë sociale, si dhe kushtet e përgjithshme të punës së gazetarëve që u përkeqësuan gjatë pandemisë COVID-19, mbeten një çështje shqetësuese. Gjatë vitit 2021 u regjistruan disa raste sulmesh fizike, kërcënimesh dhe kanosjesh ndaj gazetarëve. Rasti më i rëndë ishte hetimi i nisur nga Prokuroria Speciale Antikorrupsion kundër portalit të lajmeve *Lapsi.al* për të detyruar gazetarët të zbulonin burimin e rrjedhjeje masive të dhënash personale. Në prill të vitit 2021, GJEDNJ dha një vendim duke vendosur një masë sigurie për të parandaluar sekuestrimin e serverëve dhe të dhënave kompjuterike të medias online (KiE, 2021).

Treguesi mbi **Pavarësinë dhe efikasitetin e autoritetit të medias** u vlerësua në masën 42% për vitin 2021. Ky është rezultat i perceptimit të përbashkët në komunitetin mediatik se Autoriteti i Mediave Audiovizive nuk është i pavarur nga presioni i panevojshëm politik dhe i korporatave. Sipas opinionit të Komisionit të Venecias për ndryshimet e propozuara për Ligjin për Mediat Audiovizive të Shqipërisë, anëtarët e bordit të AMA-s kanë një përkatësi të qartë politike, ku anëtarët e propozuar nga partia/koalicioni qeverisës kanë një shumicë të lehtë në këtë organ. Në të njëjtën kohë, ata gjithashtu perceptohen të jenë nën ndikimin e mediave të mëdha dhe interesave të veçanta të industrisë (Komisioni i Venecias, 2020). Megjithëse në vitin 2021 nuk u miratua asnjë legjislacion i ri për të vendosur kufizime në lirinë e medias për shkak të pandemisë COVID-19, kërcënimet dhe përpjekjet e vazhdueshme të qeverisë për të rregulluar mediat online duke zgjeruar fushëveprimin e Autoritetit të Medias Audiovizive, i cili perceptohet si i kontrolluar politikisht pas emërimit të zëdhënëses së qeverisë si kryetare të këtij organi, mbetet një çështje shqetësuese.

3.2. Pluralizmi i Tregut (87% - Rrezik i lartë)

Fusha e Pluralizmit të Tregut përqendrohet në rrezikun ekonomik ndaj pluralizmit të medias që rrjedh nga mungesa e transparencës dhe përqendrimi i pronësisë, qëndrueshmëria e industrisë mediatike, si dhe ekspozimit të gazetarëve ndaj interesave tregtare. Treguesi i parë vlerëson ekzistencën dhe efikasitetin e dispozitave mbi transparencën e pronësisë së medias. Mungesa e konkurrencës dhe pluralizmi i jashtëm vlerësohet veçmas për median informative (prodhimin e lajmeve) dhe për platformat online (kanalet e shpërndarjes së lajmeve), duke marrë në shqyrtim përqendrimin horizontal si dhe përqendrimin mes llojeve të ndryshme të medias; shqyrtohet përqendrimi i tregut të reklamave online; dhe roli i zbatimit të konkurrencës. Treguesi mbi masat e qëndrueshmërisë së mediave vlerëson tendencat e të ardhurave dhe punësimit në raport me tendencën e PBB-së. Treguesi i fundit synon të vlerësojë rreziqet për pluralizmin e medias që vijnë nga interesat e biznesit mbi prodhimin e përmbajtjes editoriale, si nga tregu ashtu edhe nga pronarët e medias.



Gjatë vitit 2021, fusha e Pluralizmit të Tregut u vlerësua me rrezik të lartë (87%), duke u përmirësuar me vetëm dy pikë përqindje krahasuar me vitin 2020. Pavarësisht se të gjithë treguesit e kësaj fushe vlerësohen me rrezik të lartë gjatë vitit 2021, me rrezik veçanërisht të lartë janë vlerësuar treguesit lidhur me përqendrimin e platformave online dhe zbatimin e konkurrencës, si dhe ndikimin e padrejtë të pronarëve dhe aktorëve tregtarë në politikën editoriale. Për shkak të mangësive në rregullimin e tregut, nuk ka asnjë raportim zyrtar nga autoritetet ose nga vetë kompanitë. Kjo çon në mungesën e të dhënave që vlerësohen si rrezik i shtuar lidhur me transparencën e tregut mediatik.

Treguesi i **Transparencës së pronësisë së medias** vlerësohet me 81%, duke u renditur me rrezik të lartë dhe duke mos regjistruar asnjë ndryshim në krahasim me vitin 2020. Kuadri ligjor i Shqipërisë nuk përmban dispozita specifike për transparencën e pronësisë së medias, me përjashtim të transmetuesve audiovizivë, të cilët janë të detyruar të regjistrohen si entitete të veçanta. Të dhëna të tilla mblidhen dhe shpërndahen nga Autoriteti i Mediave Audiovizive, por gjithashtu është e mundur të aksesohen dhe përmes Regjistrimit Kombëtar të Biznesit për mediat audiovizive, si dhe disa media të tjera. Mediat online vendase nuk janë të

rregulluara në Shqipëri dhe detyrimi i tyre i vetëm është regjistrimi i domeinit, i cili mund të bëhet nga çdo individ ose subjekt tregtar/jofitimprurës.

Treguesi i **Përqendrimit të medias** vlerësohet me 89%. Ai është vlerësuar me rrezik i lartë për shkak të mungesës së rregullimit të pronësisë dhe përqendrimit të tregut për median e shtypur dhe atë online. Ky tregues nuk ka regjistruar asnjë ndryshim në vlerësimin e tij të rrezikut në krahasim me vitin 2020. Ligji për Median Audiovizive mbart disa kufizime të pronësisë vetëm nëse një individ ka nën pronësi më shumë se sa një kompani mediatike. Ky ligj parashikon gjithashtu kufizime të karakterit tregtar, të cilat lidhen me ndalimin e marrjes së më shumë se 30% të tregut të reklamave nga një kompani që ka një licencë kombëtare radio apo radiotelevizioni. Ka mungesë të të dhënave për tregun dhe audiencën e mediave më të mëdha televizive, radiofonike, të shtypura dhe online. Në ligjin shqiptar nuk ka dispozita për të parandaluar një shkallë të lartë përqendrimi të pronësisë së tërthortë midis llojeve të ndryshme të mediave.


Treguesi i **Përqendrimit të platformave online dhe zbatimit të konkurrencës** vlerësohet me rrezik të lartë në masën 97%. Ky pikëzim vjen kryesisht për shkak të mungesës së të dhënave për përqendrimin e tregut dhe audiencës, si dhe mungesës së të dhënave mbi mënyrën e konsumit të medias, veçanërisht për aksesin në lajmet online. Për sa i përket zbatimit të konkurrencës, një shkallë e lartë e përqendrimit të pronësisë nuk mund të parandalohet në mënyrë efektive nëpërmjet zbatimit të rregullave të konkurrencës, sepse në vitin 2017, Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës vendosi se nuk ka kompetencë që të shqyrtojë një ankesë ndaj një mediumi audioviziv, pasi fusha mediatike bie ekskluzivisht nën juridiksionin e Autoritetit të Mediave Audiovizive. Në Shqipëri nuk ka asnjë kuadër ligjor specifik që rregullon tregun e reklamave dixhitale, as ndonjë formë taksimi mbi shërbimet dixhitale (BIRN Albania, 2020).

Treguesi i **Qëndrueshmërisë së medias** vlerësohet me 78%, pra me rrezik të lartë. Ky tregues ka shënuar përmirësim nga një vit më parë, kur shënoi një rezultat prej 94%. Në përgjithësi nuk kishte të dhëna të disponueshme për televizionet kryesore dhe ishte e pamundur të vlerësohej ndikimi i krizës së COVID-19 mbi to. E njëjta gjë ishte e vërtetë për radiot, mediat e shtypura dhe ato online vendase. Si rezultat, ishte e pamundur të vlerësohej nëse të ardhurat totale të sektorit të medias u rritën apo u ulën gjatë vitit 2021. Gjithashtu nuk kishte të dhëna për reklamat totale (online dhe offline) në mediat shqiptare në vitin 2021. Nuk raportohen nisma për zhvillimin e burimeve të reja të të ardhurave për median, si abonimet apo reklamat në Google, ndërkohë që shteti nuk krijoi ndonjë skemë mbështetëse për mediat në Shqipëri për të përballuar pandeminë. Mungesa e të dhënave financiare vjen për faktin se pasqyrat financiare për çdo vit financiar bëhen publike nga Regjistri Kombëtar i Bizneseve vetëm në tremujorin e tretë të vitit pasardhës. Dëshmi të mbledhura nga informatorë të rëndësishëm sugjerojnë se punësimi në mediat kombëtare ka qenë konstante gjatë vitit 2021.

Sipas Barometrit Kombëtar për Lirinë e Medias (Komiteti Shqiptar i Helsinkit, 2020), bizneset që reklamojnë në media perceptohen si kërcënim për lirinë e medias nga 35% e gazetarëve, ndërsa 80% e gazetarëve të intervistuar renditën si kërcënim interesat e biznesit të pronarëve të mediave. Si rezultat, treguesi i **Ndikimit të interesave tregtare dhe pronarëve në përmbajtjen editoriale** u vlerësua me 90% , pra me rrezik të lartë, duke u përmirësuar me një pikë përqindje të vetme nga viti 2020. Në Shqipëri nuk ka mekanizma që garantojnë mbrojtjen shoqërore të gazetarëve në rast të ndryshimit të pronësisë apo vijës editoriale dhe nuk ka dispozita rregulluese apo vetërregulluese për të siguruar që vendimet në lidhje me emërimin dhe shkarkimin e kryeredaktorëve nuk ndikohen nga interesat tregtare të pronarëve. Kodi i Etikës së Gazetarit (Instituti Shqiptar i Medias, 2018) përcakton se përmbajtja editoriale duhet të dallojë qartë nga reklamat; megjithatë, kodi nuk zbatohet nga shumica e mediave. Nuk ka të dhëna për shkallën e reklamave të fshehura në vitin 2021, pavarësisht se ky ka qenë një problem sistematik në të kaluarën.

3.3. Pavarësia Politike (69% - Rrezik i lartë)

Treguesit e Pavarësisë Politike masin ekzistencën dhe efikasitetin e masave mbrojtëse rregulluese dhe vetërregulluese kundër anësisë politike dhe ndikimeve politike mbi prodhimin e lajmeve, shpërndarjen dhe aksesin. Më specifikisht, kjo fushë synon të vlerësojë ndikimin e shtetit dhe, më në përgjithësi, të pushtetit politik mbi funksionimin e tregut të medias dhe pavarësisë së medias publike. Për më tepër, kjo fushë ka të bëjë me ekzistencën dhe efikasitetin e (vetë)rregullimit në sigurimin e pavarësisë editoriale dhe disponueshmërisë së informacionit dhe këndvështrimeve politike të larmishme, veçanërisht gjatë periudhave zgjedhore.



Fusha e Pavarësisë Politike ndryshoi gjatë vitit 2021 nga rrezik mesatar në rrezik të lartë (69%), krahasuar me një vit më parë kur regjistroi një rezultat prej 64%. Kjo vjen kryesisht për shkak të dy treguesve kryesorë: mungesës së pavarësisë editoriale dhe mungesës së pavarësisë së medias nga politika.

Treguesi i **Pavarësisë politike të medias** vlerësohet me 85%, duke u renditur si rrezik i lartë. Ky tregues u përkeqësua në renditje krahasuar me vitin 2020, kur u vlerësua me 79%. Kontrolli politik mbi mediat audiovizive në Shqipëri është i lartë. Megjithëse nuk ka rast të njohur të pronësisë së drejtpërdrejtë të medias audiovizive nga politikanët apo familjarët e tyre, kontrolli politik ushtrohet përmes interesave të lidhura të biznesit që pronarët e medias kanë në sektorë me rregullim të lartë shtetëror, të tilla si ndërtimi, minierat dhe burimet natyrore në përgjithësi, apo mallrat me taksa akcize, të tilla si kafeja (RSF & BIRN Albania, 2018). Shumica e profesionistëve të medias raportojnë në sondazhe se presioni nga pushteti vendor dhe qendror, si dhe partitë politike janë dy faktorët kryesorë që çojnë në censurë në median shqiptare (IDRA, 2019; Komiteti Shqiptar i Helsinkit, 2020). Për më tepër, të dhënat nga një monitorim i mediave audiovizive i kryer nga AMA gjatë fushatës së fundit elektorale në Shqipëri, treguan se të gjitha televizionet kryesore në vend kanë favorizuar partinë politike në pushtet në mbulimin e tyre, pavarësisht parashikimeve ligjore në fuqi (Likmeta, B., 2021). Gjithashtu, Raporti i fundit i Progresit (Komisioni Evropian, 2021) thekson se “ndikimi i fortë i politikës dhe biznesit mbi median mbetet një burim kyç shqetësimi për lirinë e shprehjes në vend”. Në shtator 2021, qeveria themeloi Agjencinë për Media dhe Informim, një organ i ri i ngarkuar me centralizimin e të gjitha komunikimeve qeveritare, kryerjen e sondazheve dhe monitorimin

e mediave online. Në krye të agjencisë u emërua Endri Fuga, Drejtori i Komunikimit i kryeministrit Edi Rama. Themelimi i Agjencisë ka alarmuar organizatat për të drejtat e njeriut, të cilat druhen se kjo do t'i mundësojë qeverisë të mbysë më tej lirinë e medias dhe të reduktojë më tej qasjen e medias në burimet qeveritare (Media Freedom Rapid Response, 2021). Agjencia ka që nga dhjetori 2021, një staf prej 61 vetash dhe drejtori i saj ka statusin e Ministrit të Shtetit (Gjoka, B., 2022).

Treguesi i **Pavarësisë editoriale** ka marrë një rezultat prej 97% dhe vlerësohet si rrezik i lartë, duke regjistruar një përkeqësim me nëntë pikë përqindjeje nga vlerësimi i mëparshëm. Ky tregues renditet me rrezik të lartë për shkak të mungesës së masave mbrojtëse rregullatore për të garantuar pavarësinë gjatë emërimit dhe shkarkimit të kryeredaktorëve të organeve mediatike. Për më shumë, emërimet dhe shkarkimet e kryeredaktorëve në praktikë nuk janë të pavarura nga ndikimi politik. Edhe pse Kodi i Etikës së Gazetarëve parashikon pavarësinë e medias nga ndërhyrjet politike, ai nuk është miratuar nga të gjitha mediat dhe nuk zbatohet në mënyrë efektive. Në vitin 2020, 16 media lançuan një mekanizëm vetërregullues të quajtur Aleanca për Median Etike, por asnjë prej mediat më të mëdha për çdo kategori nuk janë pjesë e kësaj aleance. Vetëm disa media të mëdha private kanë miratuar, të paktën në letër, dokumente të brendshme për të siguruar pavarësinë editoriale duke ndarë redaksitë nga menaxherët dhe departamentet e marketingut. Sipas sondazheve të perceptimit publik, pronarët e mediave dhe subjektet e tjera politike dhe tregtare ndikojnë sistematikisht në përmbajtjen e tyre editoriale (Ipsos Strategic Marketingu, 2021).

Treguesi për **Mediat audiovizive, platformat online dhe zgjedhjet** ka arritur një rezultat prej 57% dhe vlerësohet me rrezik mesatar. Ky tregues ka rënë me 13 pikë përqindje krahasuar me vitin 2020, kur mori një pikë prej 44%. Rënia e madhe në renditjen e këtij treguesi është për shkak të favorizimit të shfaqur nga mediat komerciale audiovizive ndaj partisë në pushtet në zgjedhjet parlamentare të prillit 2021 (Likmeta, B., 2021). Nuk ka asnjë rregullore që synon të sigurojë transparencën e reklamave politike në platformat online gjatë fushatës elektorale. Partitë politike shqiptare nuk janë transparente për shpenzimet dhe teknikat e përdorura në fushatat politike të mediave sociale. Në zgjedhjet parlamentare të 2021, asnjë nga partitë vendore nuk vuri në dispozicion në faqen e tyre të internetit informacion mbi shpenzimet e tyre për aktivitetet online, duke përfshirë reklamat politike dhe komunikimet online me pagesë (Likmeta, B., 2021). Komisioneri për të Drejtën e Informacionit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nuk ka ndërmarrë masa monitoruese të mjaftueshme lidhur me përdorimin e të dhënave personale të qytetarëve nga partitë politike gjatë fushatave elektorale. Gjatë fushatës parlamentare të prillit 2021, u zbulua një bazë të dhënash që përmbante të dhënat personale dhe detajet e kontaktit të rreth 900,000 votuesve shqiptarë, duke përfshirë edhe preferencat e tyre politike, duke ngritur shumë shqetësime për aktorët vendas dhe ndërkombëtarë (Komisioni Evropian, 2021).


Treguesi mbi **Rregullimin shtetëror të burimeve dhe mbështetjes për sektorin e medias** u vlerësua në masën 58%, duke u renditur si rrezik i mesëm. Ky tregues nuk ka shënuar asnjë ndryshim në përqindje krahasuar me vitin 2020. Kjo renditje vjen kryesisht si pasojë e rrezikut që lidhet me mungesën ose rregulloret/procedurat evazive për shpërndarjen e reklamave shtetërore. Mungesa e procedurave të hapësirë për abuzime, veçanërisht në tregun e mediave audiovizive, sepse nuk ekziston një mekanizëm për të garantuar që fushatat promovuese të institucioneve shtetërore të jepen në bazë të audiencës. Kur fushatat reklamuese i jepen agjencive reklamuese, këto të fundit nuk janë të detyruara të ndjekin ndonjë rregull specifik për shpërndarjen/dhënien e fushatës në media të ndryshme. Qeveria dhe institucionet publike nuk monitorojnë dhe nuk bëjnë transparente mënyrën e shpërndarjes së reklamave shtetërore.

Treguesi i **Pavarësisë e qeverisjes dhe financimit së Transmetuesit Publik** është vlerësuar me 50%, pra

me rrezik të mesëm, duke mos shënuar ndryshime krahasuar me një vit më parë. Rreziku është vlerësuar si mesatar si rezultat i ndërhyrjes politike në emërimin e drejtuesve të transmetuesit publik. Gjithashtu, nga dhjetori 2020 deri në maj 2021, Parlamenti (i dominuar vetëm nga partia qeverisëse në atë kohë) zëvendësoi të gjithë anëtarët e bordit të transmetuesit publik të cilëve u kishte mbaruar mandati, duke përfshirë edhe kryetarin. Një lëvizje e tillë u kritikua shumë nga aktorët vendas, të cilët i kërkuan Kuvendit të shtynte përzgjedhjen e anëtarëve të bordit derisa opozita të ishte e pranishme dhe të ushtronte të drejtën e saj për të shkarkuar disa prej kandidatëve. Nga katër anëtarët e rinj të bordit të transmetuesit publik shqiptar, dy konsiderohen nga aktorët vendas se kanë përkatësi të qartë politike (Erebara, Gj., 2021).

3.4. Gjithëpërfshirja Sociale (64% - Rrezik i mesëm)

[NOTA_2030][NOTA_2026][NOTA_2028][NOTA_2025] *Gjithëpërfshirja Sociale është një fushë që përqendrohet në aksesin në media të grupimeve specifike të një shoqërie: minoritetet, bashkësitë vendore apo rajonale, gratë dhe njerëzit me aftësi të kufizuara. Ky tregues ekzaminon gjithashtu mjedisin e njohurive mbi median të një vendi (edukimi mediatik), përfshirë aftësitë dixhitale të popullsisë së gjerë. Përveç kësaj, për edicionin e vitit 2021 të MPM-së, një tregues i ri është shtuar në fushën e Gjithëpërfshirjes Sociale në mënyrë që të vlerësojë sfidat e reja që janë shfaqur nga përdorimi i teknologjive dixhitale: mbrojtja nga gjuha e paligjshme ose ajo e dëmshme. Për shkak të modifikimit të treguesve, krahasimi me edicionet e mëparshme të MPM-së duhet të trajtohet me kujdes maksimal.*



Fusha e Gjithëpërfshirjes Sociale u rendit me rrezik mesatar gjatë vitit 2021, duke regjistruar një përmirësim me tetë pikë përqindjeje krahasuar me një vit më parë, nga 72% në 64%. Kjo fushë përfshin dhe treguesin e vetëm në MPM2022 për Shqipërinë që renditet me rrezik të ulët: Aksesi në media për komunitetet lokale/rajonale dhe për mediat komunitare.

Treguesi i **Aksesit në media për minoritetet** është vlerësuar me 63% këtë vit, tre pikë përqindje më keq se në edicionin e kaluar të MPM-së. Bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”^[12], pakicave u garantohet dhe gëzojnë të drejtën për të shprehur mendime dhe pikëpamje, si dhe për të marrë dhe shpërndarë informacion në gjuhën e pakicës, pa

diskriminim dhe pa ndërhyrjen e autoriteteve publike. Ashtu si dhe në vitet e mëparshme, pakicat kanë ende akses të kufizuar në kohën e transmetimit në kanalet e transmetuesit publik. Kanali RTSH 2 aktualisht transmeton programe në pesë gjuhët e pakicave: greke, malazeze, maqedonase, rome dhe vllahe. Këto programe përbëhen nga një përkthim 30-minutësh i edicionit kryesor të lajmeve të transmetuesit publik në gjuhën përkatëse. Gjithashtu, dy nga stacionet televizive rajonale të transmetuesit publik prodhojnë në baza javore programe në gjuhët e pakicave më të mëdha në zonat e tyre përkatëse: maqedonase dhe rome për RTV Korça - greke dhe arumune për RTV Gjirokastrë (RTSH, 2021). Pavarësisht se aksesit i minoriteteve në kohën e transmetimit në transmetuesin publik nuk konsiderohet i kënaqshëm, minoritetet nuk kanë aspak qasje në kohën e transmetimit në televizionet dhe radiot private. Paralelisht, në Planin Kombëtar të Veprimit 2021-2025^[13] ekzistojnë disa dispozita për lehtësimin e aksesit në media për personat me aftësi të kufizuara, të përmbledhura nën "Objektivin specifik 3. Sigurimi i aksesit në informacion dhe në komunikim". Megjithatë, masat ekzistuese për të siguruar aksesin në media për personat me aftësi të kufizuara mbeten të fragmentuara dhe të pazbatuara në mënyrë efektive siç theksohet nga të dhënat e monitorimit të Planit të mëparshëm të Veprimit (World Vision Albania, 2020).

Treguesi **Akses në media për komunitetet lokale dhe mediat komunitare** u vlerësua me një rezultat prej 31%, brenda kufijve të rrezikut të ulët, duke shënuar një përmirësim prej 13 pikë përqindjeje krahasuar me një vit më parë. Nenet 63 të ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"^[14] u jep akses mediave rajonale ose lokale në platformat mediatike. Megjithatë, mungesa e subvencioneve për mediat lokale ka bërë që disa pronarë të mediave të ankohen se kostot për hostuar mediat e tyre në platformat ekzistuese mediatike janë shumë të larta. Transmetuesi publik nuk është i detyruar me ligj të mbajë korrespondentë apo degë lokale/rajonale, por statuti i tij, sipas nenit 13^[15], parashikon që PSM duhet të ketë aktive të paktën katër degë rajonale audiovizive. Përveç korrespondentëve, PSM ka edhe katër transmetues lokalë, RTSH Kukësi, RTSH Shkodra, RTSH Gjirokastra dhe RTSH Korça. Ky tregues rezultoi dukshëm me më pak rrezik se në vitin 2022, për shkak të rënies së madhe të pikëve të nëntreguesit *Akses në mediat rajonale/lokale*, i cili ndryshoi nga 63% në 38% rrezik për shkak të ndryshimit të metodologjisë. Në MPM-në e vitit 2022 ky nënindikator përfshin një variabël shtesë krahasuar me vitin 2021, i cili vlerësohet pozitivisht dhe si rezultat ul nivelin e rrezikut për të gjithë nënindikatorin.

Treguesi i **Aksesit të grave në media** ka një rezultat prej 90% dhe vlerësohet si rrezik i lartë. Ky tregues nuk ka shënuar ndryshim në përqindje krahasuar me vitet e mëparshme, ku njësoj vlerësohej si rrezik i lartë. Vlerësimi negativ është për faktin se transmetuesi publik nuk ka asnjë politikë të barazisë gjinore dhe në statutin e tij nuk parashikohen dispozita për barazinë gjinore në organet vendimmarrëse. Në vitin 2021, vetëm dy nga nëntë anëtarët e Bordit Drejtues të transmetuesit publik ishin gra, ndërsa të pesë menaxherët kryesorë vijuan të ishin burra. Përveç kësaj, ndër gjashtë anëtarë të bordit të dy televizioneve kryesore komerciale nuk ka asnjë grua. Të gjithë kryeredaktorët e mediave më të rëndësishme audiovizive, radiofonike, gazetave dhe dixhitale vendase në Shqipëri janë burra. Një studim i fundit ka treguar se në emisionet televizive, rreth 73% e të ftuarve janë meshkuj, ndërsa vetëm 27% e tyre janë femra. Përfshirje përbëjnë emisionet sportive, ku gratë shihen më së shumti në rolin e tretë, si objekt seksual (Pro LGBT, 2020).


Treguesi i **Edukimit mediatik** është vlerësuar me 67%, duke shënuar rrezik të lartë. Treguesi është përmirësuar me katër pikë përqindje krahasuar me edicionin e mëparshëm të MPM-së. Shqipëria nuk ka zhvilluar politika specifike për edukimin mediatik, por në disa raste ato janë pjesë e një rregullimi më të gjerë. Për shembull, neni 3 i ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë"^[16] dhe kuadri i kurrikulës^[17] përfshin disa elementë që klasifikohen si edukim mediatik, si p.sh. zbërthimi i përmbajtjes, elementet e reklamës, mënyra e shkrimit të një artikulli, etj.. Në vitin 2021, Instituti

Shqiptar i Medias pilotoi një draft kurrikulë bazuar në udhëzimet e UNESCO-s në 10 shkolla të vendit, ndërsa 10 shkolla të tjera iu bashkuan fazës pilot në janar 2022^[18]. Trajnimi i mësuesve për edukimin mediatik është shumë i kufizuar në numër dhe është ofruar vetëm përmes disa projekteve të organizatave të shoqërisë civile.

Treguesi i **Mbrojtjes kundër gjuhës së paligjshme dhe të dëmshme** ka një rezultat prej 71% dhe vlerësohet si rrezik i lartë. Ky tregues ka shënuar një përmirësim prej 23 pikë përqindjeje krahasuar me vitin 2020, kur niveli i rrezikut u përlogarit në 94%. Përmirësimi vjen si rezultat i ndryshimeve të fundit të ligjit nr. 10 221 datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”^[19] i miratuar në fund të vitit 2020, i cili ka përfshirë përkufizimin e parë të “gjuhës së urrejtjes” në kuadrin rregullator shqiptar, duke e njohur atë edhe si një formë diskriminimi. Nuk ka asnjë rregullore specifike, as ligje apo politika për dezinformimin në Shqipëri, as përdorim të drejtpërdrejtë të këtij termi apo një përkufizim ligjor se çfarë përbën dezinformim. Partitë politike, oligarkët dhe grupet e interesit angazhohen në mënyrë rutinore në fushata dezinformuese të brendshme, të cilat janë bërë një tipar i kudondodhur i garave të brendshme politike (Londo, I., 2021). Ka relativisht pak prova të përpjekjeve të fuqive të huaja për të shtrembëruar politikën shqiptare apo marrëdhëniet ndërkombëtare. Disa raste dezinformimi janë të lidhura me përpjekjet e mediave për të rritur trafikun/audiencën ose nevojën e politikanëve për të regjistruar më shumë ndjekës në kanalet e tyre të mediave sociale (Bashkimi Evropian, 2021).

4. Pluralizmi në mjedisin online: vlerësimi i rreziqeve

Shqipëri: Fushat e Rrezikut të Pluralizmit të Medias



JS chart by amCharts



Vlerësimi i **Pluralizmit të Medias Online** në Shqipëri varion nga rreziku mesatar në atë të lartë. Të katër fushat janë vlerësuar me një rrezik më të lartë në sferën online në krahasim me të gjitha mediat. Për sa i përket mediave dixhitale në Shqipëri, fusha e Mbrojtjes Themelore ka emëruesin më të ulët të rrezikut, e renditur si rrezik mesatar me 65%, e ndjekur nga Përfshirja Sociale me 84%, Pluraliteti i Tregut me 88% dhe Pavarësia Politike me 97% - ku tre fushat vlerësohen me rrezik të lartë. Niveli i rrezikut lidhet shumë herë me mungesën e dispozitave ligjore, si dhe me mungesën e sistemeve të mbledhjes dhe raportimit të të dhënave nga autoritetet publike, platformat online ose organizatat monitoruese.

Mbrojtja Themelore (65% - rrezik mesatar)

Liria e shprehjes në internet nuk është e përcaktuar qartë në ligj. Megjithatë, në praktikën gjyqësore, në lidhje me veprën penale të shpifjes ose paditë civile për shpifje, mediat online kanë të njëjtat përgjegjësi dhe detyrime si mediat audiovizive ose të shkruara (BIRN Albania, 2020). Në vitin 2019, qeveria u përpoq të zgjeronte fushëveprimin e Ligjit për Media Audiovizive, por nisma u anulua për shkak të kundërshtimit të gazetarëve, organizatave mediatike, BE-së dhe Këshillit të Evropës (Erebara, Gj., 2020). Sipas Databazës së Hartëzimit të Lirisë së në Shqipëri, gjatë vitit 2020 është raportuar një kërcënim në internet kundër sigurisë së një gazetari. Megjithatë, niveli i ngacmimeve online mund të jetë më i lartë pasi nuk ka të dhëna sistematike që mbledhen në lidhje me këtë aspekt (ECPMF, 2021).

Asnjë ligj specifik nuk rregullon në mënyrë eksplicite filtrimin dhe bllokimin e përmbajtjeve të paligjshme online, megjithatë, dispozitat e disa ligjeve rregullojnë përmbajtjen e paligjshme në internet. Grupimet mbikëqyrëse të lirisë së medias nuk raportuan asnjë kufizim arbitrar, filtrim/heqje të përmbajtjes në mënyrë

arbitrare nga shteti apo platformat online në Shqipëri gjatë vitit 2021. Megjithatë, në vitin 2021, Facebook përfshiu automatikisht një lidhje referimi për përditësimet e Ministrisë së Shëndetësisë për shumicën e postimeve që lidhen me pandeminë e COVID-19. Në përgjithësi, rrjetet sociale kanë kapacitete të kufizuara për të monitoruar përmbajtjen në gjuhën shqipe për shkak të mungesës së interesimit për një treg kaq të vogël.

Qytetarët në Shqipëri kanë në dispozicion të paktën katër mekanizma ankimi për të adresuar shkeljet e të drejtave që janë kryer nga aktorë shtetërorë ose joshetërorë në mjedisin online - nëpërmjet Komisionerit Kundër Diskriminimit, Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Këshillit të Ankesave në Autoritetin e Mediave Audiovizive. Megjithatë, këta mekanizma të ofruar nga aktorët shtetërorë nuk janë të njohur dhe as shumë efektive në adresimin e ankesave. Gjithashtu, mungon tradita dhe besimi në organet vetërregulluese në këtë drejtim.

Sipas Autoritetit të Komunikimit Elektronik dhe Postar (2021), gjatë vitit 2021, 67% e popullsisë ka qenë e mbuluar nga mbulimi me brez të gjerë, nga 63% në 2020. Përqindja e popullsisë me akses broadband 3G/4G, bazuar në tre kompanitë celulare që operojnë në vend, është 70%. Ligji për Komunikimet Elektronike^[20] i referohet neutralitetit të rrjetit sipas nenit 1, qëllimi i ligjit, por nuk ka dispozita specifike se si të zbatohet dhe nuk ka të dhëna apo praktika gjyqësore të raportuara nga Autoriteti për Komunikimet Postare dhe Elektronike në këtë drejtim.

Pluralizmi i Tregut (88% - rrezik i lartë)

Në Shqipëri nuk ka asnjë ligj që kërkon deklarimin e pronësisë së medias online tek organet publike dhe aktiviteti i mediave online nuk është i rregulluar. Edhe pse Shqipëria ka miratuar Ligjin për Pronarët Përfitues^[21] (pronarët me deri në 20% të aksioneve) për të gjitha kompanitë e regjistruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit, është e vështirë që të identifikohen pronarët që zotërojnë mediat dixhitale, pasi ata mund të jetë pjesë e kompanive me aktivitet më të gjerë. Nuk ka parashikime ligjore në lidhje me përqendrimin që zbatohen për mediat online, as dispozita për të parandaluar shkallën e lartë të pronësisë vertikale ndërmjet mediave të ndryshme. Gjithashtu, nuk ka të dhëna për tregun dhe audiencën e mediave online në vend.

Në Shqipëri nuk ka të dhëna të raportuara për mënyrën kryesore se si njerëzit aksesojnë lajmet në internet. Megjithatë, sipas sondazhit të Eurobarometrit, kur qytetarët kërkonin informacion për BE-në, politikat dhe institucionet e saj, 21% e të anketuarve në Shqipëri thanë se e marrin informacionin përmes faqeve të internetit, 19% nga rrjetet sociale online, 3% nga blogjet dhe 6% nga faqet e internetit të hostimit të videove (Komisioni Evropian, 2021). Në Shqipëri nuk ka një kuadër ligjor specifik që rregullon tregun e reklamave dixhitale, gjë që rezulton në mungesë të të dhënave për madhësinë e tregut të reklamave online, të ardhurat e sektorit të mediave online vendase, si dhe cilat media janë konkurrentët kryesorë në hapësirën dixhitale.

Kodi i Etikës së Gazetarëve mbulon dhe punën gazetareske në mediat online, por ai nuk është miratuar nga shumica e mediave. Në vitin 2020, një sërë mediash online nisën një aleancë për etikën e medias me qëllim përmirësimin e zbatimit të Kodit të Etikës dhe instaluan një mekanizëm vetërregullues të bazuar në të. Deri në fund të vitit 2021, vetëm pak media janë bashkuar me aleancën (KiE, 2021). Kodi i Etikës parashikon që reklamuesit dhe reklamat duhet të etiketohen qartë, por ky rregull shkelet rregullisht nga mediat dhe nuk ka asnjë mekanizëm sanksionues në lidhje me këtë aspekt.

Pavarësia Politike (97% - rrezik i lartë)

Mediat kryesore online në Shqipëri janë të lidhura politikisht. Kjo nuk përfshin pronësinë direkte, por kryesisht kontrollin indirekt përmes financimit. Në disa raste, pronësia e faqeve të lajmeve nuk është e njohur dhe burimi i financimit të tyre është gjithashtu i errët. Bazuar në të dhënat e publikuara nga Instituti Shqiptar i Medias (2018), të paktën 1 në 10 media online nuk janë të regjistruara në asnjë formë dhe 1 në 3 faqe lajmesh funksionojnë pa të ardhura të dukshme nga reklamat, duke arritur në përfundimin se ka mungesë transparence dhe anonimat të konsiderueshëm në mediat online. Gjithashtu, të dhënat nga një sondazh i vitit 2019 mbi peizazhin mediatik në Shqipëri tregojnë se gazetarët në mediat online janë më të prirur për të raportuar raste censure dhe vetëcensure, si dhe heqjen e artikujve nga pronarët dhe redaktorët e tyre në krahasim me gazetarët që punojnë në shtyp dhe mediat audiovizive (IDRA, 2019).

Nuk ka asnjë rregullimin që synon të sigurojë mundësi të barabarta për reklamim politik gjatë fushatave elektorale në mediat online apo ndonjë mekanizëm monitorues për shpenzime në këtë drejtim. Pavarësisht mungesës së një kuadri rregullator për mediat online, si në mbulim ashtu edhe në reklamim politik gjatë fushatës, partitë politike dhe kandidatët duhet të raportojnë të gjitha shpenzimet, pavarësisht nga mediumi i përdorur për reklamim. Në mënyrë të ngjashme nuk ka asnjë rregullore që synon të sigurojë transparencën e reklamave politike në platformat online gjatë fushatave elektorale. Në zgjedhjet parlamentare të 2021, asnjë nga partitë vendore nuk vuri në dispozicion në faqen e tyre të internetit informacion mbi shpenzimet e tyre për aktivitetet online, duke përfshirë reklamat politike dhe komunikimet me pagesë (Likmeta, B., 2021).

Gjithëpërfshirja sociale (84% - rrezik i lartë)

Sipas Eurostat (2020), gjatë vitit 2019, 21% e popullsisë së Shqipërisë ka aftësi dixhitale bazike ose pak mbi bazëken, ndërsa 47% e popullsisë ka aftësi të përgjithshme dixhitale të ulëta. Mungesa e aftësie dixhitale krijon hapësirë për partitë politike, oligarkët dhe grupet e interesit për t'u përfshirë në mënyrë rutinore në fushata dezinformimi në vend. Një raport i publikuar nga Parlamenti Evropian (2021) nënvizon se në Shqipëri, dezinformimi është një tipar i kudondodhur i konkurrencës politike të brendshme, por përpjekjet janë përgjithësisht oportuniste dhe fushatat janë të shkurtra. Ka relativisht pak prova të përpjekjeve të fuqive të huaja për të shtrembëruar politikën shqiptare apo marrëdhëniet ndërkombëtare.

Të dhënat e analizuara nga BIRN Albania në lidhje me informacionin e lidhur me COVID-19, treguan se Shqipëria përbën një terren pjellor për teoritë konspirative (përfshirë anti-vakserët) dhe lajmet e rreme në lidhje me pandeminë e koronavirusit, si në mdeiat sociale, ashtu edhe në mediat kryesore audiovizive dhe ato online (Likmeta, B., 2020). Si rezultat, raportet rajonale tregojnë se vendi me numrin më të madh të mbështetësve të ndonjë prej teorive konspirative të COVID-19 në Ballkanin Perëndimor është Shqipëria, me më shumë se 80% të popullsisë që beson shumë, ose në një farë mase në këto teori. Besime të tilla në teoritë e konspiracionit kanë ndikuar gjithashtu në besimin e qytetarëve në procesin e vaksinimit, me më shumë se 50% të njerëzve që nuk besojnë në të (BiEPAG, 2021).

Por, nën një frymë pozitive, ndryshimet e fundit të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”^[22] miratuar në fund të vitit 2020, futën përkufizimin e parë të “gjuhës së urrejtjes” në kuadrin rregullator shqiptar, duke e njohur atë si një formë diskriminimi që prek edhe rrjetet sociale dhe median online.

5. Konkluzione

Mbrojtja Themelore

- **Shqipëria duhet të bëjë më shumë për të rritur aksesin në internetin me brez të gjerë për të forcuar shtrirjen e mediave dixhitale të lajmeve. Përveç kësaj, kushtet e këqija të punës për gazetarët, të cilat shtyjnë shumë gazetarë drejt vetëcensurës, mbeten një çështje shqetësuese.**
- **Shqipëria duhet të bëjë më shumë për të mbrojtur lirinë e shprehjes në zbatim të legjislacionit ekzistues.** Çdo ndryshim në kuadrin aktual ligjor duhet të konsultohet me aktorët e medias dhe të përafrohet me standardet më të mira ndërkombëtare për lirinë e medias.
- **Duhet të bëhen më shumë përpjekje për të siguruar zbatimin e duhur të legjislacionit për të Drejtën e Informimit.** Në të njëjtën kohë, grupet watchdog duhet të monitorojnë rolin e luajtur nga Agjencia e Medias dhe Informacionit dhe ndikimin e saj në rrjedhën e informacionit.

Pluralizmi i Tregut

- Mungesa e të dhënave për tregun dhe përqendrimin e audiencës në televizione, radio, shtypin e shkruar dhe median online e bën të pamundur vlerësimin e pluralitetit të skenës mediatike në Shqipëri. **Autoriteti i Medias Audiovizive duhet të luajë një rol më aktiv në mbledhjen dhe shpërndarjen e të dhënave mbi audiencën dhe tregun e reklamave në median audiovizive.**
- **Mediat duhet gjithashtu të bëjnë përpjekje për të forcuar pavarësinë editoriale dhe për të kufizuar ndikimin e interesave politike dhe ekonomike të pronarëve të tyre në mbulimin mediatik.**

Pavarësia Politike

- **Duhet të bëhen përpjekje për të adresuar pavarësinë dhe profesionalizmin e autoritetit të medias dhe bordit të transmetuesit publik, duke siguruar që emërimet e anëtarëve të të dy institucioneve të bëhen pa ndikim politik ose të grupeve të biznesit.**
- **Duhet të vendosen rregulla të qartë për shpërndarjen e reklamave shtetërore në mënyrë që të kufizohet ndikimi i politikanëve dhe partive politike në media.**

Gjithëpërfshirja Sociale

- Përfaqësimi i grave në media mbetet i ulët dhe duhet bërë **më shumë përpjekje për krijimin e bordeve menaxhuese të balancuara në aspektin gjinor dhe promovimin e grave gazetare dhe redaktore në pozita menaxheriale.** Gjithashtu, **mediat komerciale duhet të ofrojnë hapësirë për komunitetet e pakicave etnike dhe kulturore,** veçanërisht në situatën e përqindjes së ulët të audiencës së kanaleve të transmetuesit publik.
- **Autoritetet shqiptare duhet të bëjnë përpjekje më të forta për të zhvilluar dhe shpërndarë një politikë më gjithëpërfshirëse dhe programe mësimore për edukimin mediatik në arsimin**

parauniversitar, të mbështetur nga trajnimi i mësuesve dhe pajisja me mjetet e nevojshme.

- Agjencia e Medias dhe Informimit rrezikon të bëhet një mjet censurimi - për çdo qeveri aktuale apo të ardhme - duke kontrolluar rrjedhën e informacionit publik në media dhe duke ndikuar në atë që qytetarët lexojnë, dëgjojnë dhe shikojnë.

6. Shënime

- [1] Ligji nr. 96/2017 “Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë”. <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2018/05/1524738824-Ligji-Per-Mbrojtjen-e-Pakicave-Kombetare-ne-R.Sh-2017.pdf>
- [2] Ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i amenduar. <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2013/03/04/97-2013>
- [3] Ligji nr. 7756, datë 11 Tetor 1993 “Për shtypin”, i amenduar me Ligjin nr. 8239, datë 3 Shtator 1997. <http://80.78.70.231/pls/kuv/f?p=201:Ligj:8239:03.09.1997>
- [4] Ligji nr.9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. https://www.idp.al/wp-content/uploads/2020/12/Ligj_9918_dt.19.05.2008_Per_komunikimet_elektronike_i_ndryshuar_2020.pdf
- [5] Ligji nr. 8417, datë 22.11.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”. <https://www.parlament.al/Files/sKuvendi/kushtetuta.pdf>
- [6] Ligji nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”. https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/08/Ligj_119_2014_18.09.2014.pdf
- [7] Ministria e Arsimit, 2014 “Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Shqipërisë”. <https://ascap.edu.al/wp-content/uploads/2017/03/Korniza-Kurrikulare.pdf>
- [8] Ministria e Arsimit, 2014 “Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Shqipërisë”. <https://ascap.edu.al/wp-content/uploads/2017/03/Korniza-Kurrikulare.pdf>
- [9] Ligji nr. 10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i ndryshuar. https://equineteurope.org/wp-content/uploads/2021/04/Law-on-Protection-from-Discrimination-Albania_amended-1.pdf
- [10] Ministria e Arsimit, 2014 “Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Shqipërisë”. <https://ascap.edu.al/wp-content/uploads/2017/03/Korniza-Kurrikulare.pdf>
- [11] Vendim nr. 98/2016 i Kuvendit të Shqipërisë mbi “Statutin e Radio Televizionit Shqiptar (RTSH)” <https://www.rtsh.al/rreth-rtsh/statuti-i-rtsh>
- [12] Ligji nr. 96/2017 “Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë”. <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2018/05/1524738824-Ligji-Per-Mbrojtjen-e-Pakicave-Kombetare-ne-R.Sh-2017.pdf>
- [13] Decision no. 276, dated 12.05.2021 “On the Adoption of the National Action Plan for Persons with Disabilities, 2021-2025”. <https://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/poverty/national-action-plan-for-persons-with-disabilities-2021-2025.html>
- [14] Ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i amenduar. <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2013/03/04/97-2013>
- [15] Vendim nr. 98/2016 i Kuvendit të Shqipërisë mbi “Statutin e Radio Televizionit Shqiptar (RTSH)” <https://www.rtsh.al/rreth-rtsh/statuti-i-rtsh>
- [16] Ligji nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2017/10/Ligji_Parauniversitar.pdf
- [17] Ministria e Arsimit, 2014 “Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Shqipërisë”. <https://ascap.edu.al/wp-content/uploads/2017/03/Korniza-Kurrikulare.pdf>
- [18] UNESCO & Albanian Media Institute, 2022 Project: <https://www.institutemedia.org/2020/10/27/building-trust-in-media-in-south-east-europe-and-turkey-phase-ii/> Curricula: <https://www.institutemedia.org/wp-content/uploads/2022/03/Mendim-kritik-klikim-i-mençur.pdf>
- [19] Ligji nr. 10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i ndryshuar. https://equineteurope.org/wp-content/uploads/2021/04/Law-on-Protection-from-Discrimination-Albania_amended-1.pdf
- [20] Ligji nr.9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. h

https://www.idp.al/wp-content/uploads/2020/12/Ligj_9918_dt.19.05.2008_Per_komunikimet_elektronike_i_ndryshuar_2020.pdf

[21] Ligji nr. 112/2020 “Për Regjistrin e Pronarëve Përfitues”.

[https://www.parlament.al/Files/Akte/20200804105337ligj nr. 112, dt. 29.7.2020.pdf](https://www.parlament.al/Files/Akte/20200804105337ligj_nr_112_dt_29.7.2020.pdf)

[22] Ligji nr. 10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i ndryshuar. https://equineteurope.org/wp-content/uploads/2021/04/Law-on-Protection-from-Discrimination-Albania_amended-1.pdf

7. Referenca

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit. (2021). Coronavirus Albania.

<https://coronavirus.al/statistika/>

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. (2021). Albania overview. <https://www.ebrd.com/where-we-are/albania/overview.html>

BiEPAG. (2021). The Suspicious Virus: Conspiracies and COVID19 in the Balkans - Balkans in Europe Policy Advisory Group.

<https://biepag.eu/wp-content/uploads/2021/07/Conspiracies-and-COVID19-in-the-Balkan-English-2.pdf>

BIRN Albania. (2020). Internet Governance in Albania and Its Role on Media Freedom.

<https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2020/08/Internet-Governance-1-1.pdf>

Council of Europe. (2020). Albanian Alliance for Ethical Media Establishes Self-Regulation Mechanisms.

<https://www.coe.int/en/web/tirana/-/albanian-alliance-for-ethical-media-establishes-self-regulation-mechanisms>

Council of Europe. (2021). Safety of Journalists Platform.

<https://fom.coe.int/alerte?years=2021&typeData=1&time=1637941005084>

Electronic and Postal Communications Authority. (2021) Annual Report 2020. <https://akep.al/wp-content/uploads/2021/11/Annual-Reports-2020.pdf>

Erebara, Gj. (2020, Shtator 16). Rights Groups Urge Albania to 'Rethink' Disputed Media Law. Balkan Insight. <https://balkaninsight.com/2020/09/16/rights-organizations-concerned-by-plans-to-reinstall-albania-anti-media-law/>

Erebara, Gj. (2021, Korrik 7). EU Warns Albania Against Electing 'Partisan' Media Authority Chief. Balkan Insight. <https://balkaninsight.com/2021/07/07/eu-urges-albania-socialists-to-not-vote-ramas-associate-as-new-media-authority-chief/>

Erebara, Gj. (2021, May 24). Albania Parliament's Race to Fill Media Board Causes Alarm. Balkan Insight. <https://balkaninsight.com/2021/05/24/socialists-hurry-to-elect-media-board-alarm-experts/>

European Commission. (2021). Standard Eurobarometer 94 - Winter 2020-2021 - Country Factsheets in English Albania. <https://europa.eu/eurobarometer/surveys/detail/2355>

European Union. (2021). Mapping Fake News and Disinformation in the Western Balkans and Identifying Ways to Effectively Counter Them.

[https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2020/653621/EXPO_STU\(2020\)653621_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2020/653621/EXPO_STU(2020)653621_EN.pdf)

Eurostat. (2020). Individuals' level of digital skills.

https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=isoc_sk_dskl_i&lang=en

Gjoka, B. (2022, Janar 27). Rama emëron Endri Fugën në krye të 'Ministrisë së Propagandës'. Reporter.al.

<https://www.reporter.al/2022/01/27/rama-emeron-endri-fugen-ne-krye-te-ministrise-se-propagandes/>

INSTAT. (2012). Population and Housing Census 2011.

http://www.instat.gov.al/media/3058/main_results_population_and_housing_census_2011.pdf

Institute for Development, Research and Alternatives. (2019). Albanian Media Landscape: Study on Media Professionals. <https://www.idrainstitute.org/files/Albanian%20Media%20Landscape.pdf>

Instituti Shqiptar i Medias. (2018a). Kodi i Etikës së Gazetarit. <https://kshm.al/kodi-i-etikes-se-gazetarit/>

Instituti Shqiptar i Medias. (2018b). Mapping online media in AlbaniaL Survey on online media.

https://www.osfa.al/sites/default/files/media_online_english.pdf

Ipsos Strategic Marketing. (2021). Trust in the media – Albania. https://seenpm.org/wp-content/uploads/2021/09/Trust-in-the-media-Albania_tehncial-report.pdf

Këshilli i Europës. (2021). Journalists Ordered to Hand Over Documents that Might Risk their Sources.

<https://fom.coe.int/alerte/detail/97681677:globalSearch=false>

Komisioni Europian. (2021). Albania Report 2021. https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021_en

Komisioni i Venecias. (2020). Opinion on draft amendments to law n°97/2013 on the audiovisual media service. <https://rm.coe.int/vc-opinion-albania-0620/16809ec9c9>

Komiteti Shqiptar i Helsinkit. (2020). Research Study on Journalists' Labor Rights. <https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2020/07/Research-Study-on-Journalists%E2%80%99-Labor-Rights.pdf>

Komiteti Shqiptar i Helsinkit. (2021). Barometri Kombëtar i Lirisë së Medias në Shqipëri. <https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2021/10/Barometri-Kombetar-per-Lirine-e-Media-2020.pdf>

Likmeta, B. (2020, Nëntor 4). Fake News Rivals Real News for Albanians Reading about COVID-19. Balkan Insight. <https://balkaninsight.com/2020/11/04/fake-news-rivals-real-news-for-albanians-reading-about-covid/>

Likmeta, B. (2021, Dhjetor 3). Missing Millions: Albanian Parties Underreport TV Election Ad Spending. Balkan Insight. <https://balkaninsight.com/2021/12/03/missing-millions-albanian-parties-underreport-tv-election-ad-spending/>

Likmeta, B. (2021, Qershor 2). Albanian Election Commissioner Turns Blind Eye to Broadcast Bias. Balkan Insight. <https://balkaninsight.com/2021/06/02/albanian-election-commissioner-turns-blind-eye-to-broadcast-bias/>

Londo, I. (2021). National Regulatory and Self-Regulatory Framework against Hate Speech and Disinformation – Factsheet, Albania. <https://seenpm.org/wp-content/uploads/2021/12/Resilience-Factsheet-Albania.pdf>

Media Freedom Rapid Response. (2021). Albania: MFRR urges government to scrap new Media and Information Agency. <https://www.mfrr.eu/albania-mfrr-urges-government-to-scrap-new-media-and-information-agency/>

Pro LGBT Albania. (2020). Raporti i monitorimit të medias për gjuhën e Urrejtjes. <https://www.historiaime.al/feminizmi/raporti-i-plote-i-monitorimit-te-medias-mbi-gjuhen-e-urrejtjes-seksiste-dhe-diskriminuese/>

Reporter Without Borders. (2021). Freedom of the Media Index. <https://rsf.org/en/albania>

Reporters Without Borders, BIRN Albania. (2018). Media Ownership Monitor-Albania. <http://albania.mom-rsf.org/>

RTSH. (2020). Raport Vjetor mbi Ecurinë e Radio Televizionit Shqiptar, 2019. <https://www.parlament.al/Files/Kerkese/20200429155506RAPORT%20VJETOR%20%20i%20RTSH-s%C3%AB%20per%20viti%202019-compressed.pdf>

Safejournalists.net. (2021). Western Balkans Journalists' Safety Index: Narrative Report Albania 2020. <https://safejournalists.net/wp-content/uploads/2021/11/ALB-ENG.pdf>

World Vision Albania. (2020). Raporti i dytë i monitorimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara (2016-2020). <https://www.worldvision.al/raporti-i-dyte-i-monitorimit-te-planit-kombetar-te-veprimit-personat-me-aftesi-te-kufizuara-2016>

ANEKSE I. EKIPI I STUDIMIT KOMBËTAR

Emri	Mbiemri	Pozicioni	Institucioni	MPM2022 CT Kryesues
<i>Kristina</i>	<i>Voko</i>	<i>Executive Director</i>	<i>Rrjeti Ballkanik për Gazetari Investigative në Shqipëri</i>	X
<i>Besar</i>	<i>Likmeta</i>	<i>Kryeredaktor</i>	<i>Rrjeti Ballkanik për Gazetari Investigative në Shqipëri</i>	

ANEKSE II. GRUPI I EKSPERTËVE

Grupi i Ekspertëve përbëhet nga specialistë me njohuri thelbësore dhe përvojë të njohur në fushën e medias. Roli i Grupit të Ekspertëve ishte të rishikonte përgjigjet e ekipit të vendit për 16 variabla nga 200 që përbëjnë MPM2021. Konsultimi i këndvështrimit të ekspertëve të njohur synon maksimizimin e objektivitetit të përgjigjeve dhënë variabla, vlerësimi i të cilave mund të konsiderohet si subjektive, duke siguruar saktësinë e rezultateve përfundimtare të MPM. Sidoqoftë, është e rëndësishme të theksohet se raporti përfundimtar i vendit nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet individuale të ekspertëve që morën pjesë. Ajo përfaqëson vetëm pikëpamjet e ekipit kombëtar të vendit që ka kryer mbledhjen e të dhënave dhe janë autorë të raportit.

Emri	Mbiemri	Pozicioni	Institucioni
<i>Sara</i>	<i>Xhumbari</i>	<i>Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Licensave</i>	<i>Autoriteti i Mediave Audiovizive</i>
<i>Ilda</i>	<i>Londo</i>	<i>Kërkuese kryesore</i>	<i>Instituti Shqiptar i Medias</i>
<i>Mimoza</i>	<i>Kociu</i>	<i>Coordinator</i>	<i>Association of Professional Journalists of Albania</i>
<i>Koloreto</i>	<i>Cukali</i>	<i>Drejtor Ekzekutiv</i>	<i>Këshilli Shqiptar i Medias</i>
<i>Brejdon</i>	<i>Xhavara</i>	<i>Journalist Minority Right's activist</i>	<i>COMMUNITY REPORTERS ALBANIA</i>
<i>Alba</i>	<i>Ahmetaj</i>	<i>Cofounder</i>	<i>Pro LGBT / Historia Ime</i>

Raporti i Projektit Studimor

Edicioni -
Korrik 2022

doi:10.2870/527906
ISBN:978-92-9466-260-6
QM-08-22-229-SQ-N



Publications Office
of the European Union

